



ENTI RREGULLATOR I ENER GjISË

Bordi

VENDIM

Nr. 29, datë 10.02.2020

MBI

**REZULTATET E MONITORIMIT TË KRYER PRANË OST SH.A. ME QËLLIM
VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË PLANIT TË INVESTIMEVE TË OST
SHA PËR VITET 2017 DHE 2018.**

Në mbështetje të nenit 20, gërmat ç), d), e), f), g) dhe nenit 22 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 15 të “Rregullave për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurave të ERE-s, nenit 13 të Rregullores së brendshme për organizimin funksionimin dhe procedurat e ERE, miratuar me vendimin nr.144/2019 të Bordit të ERE, Vendimit të Bordit të ERE nr.54/2019, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 10.02.2020, mbasi shqyrtoi informacionin e monitorimit të kryer pranë shoqërisë OST sh.a. nga grupi i monitorimit të ngritur nga ERE, si dhe informacionin e përgatitur nga Sekretari I Përgjithshëm dhe Drejtoria e Çështjeve Ligjore, lidhur me zbatimin e planit të Investimeve të OST sh.a. për vitet 2017 dhe 2018,

Konstatoi se:

- Në zbatim të nenit 20, gërmat ç), d), e), f), g) dhe nenit 22 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar u ngrit me Urdhërin e Kryetarit të ERE-s Nr.61 Dt.06.11.2018, Grupi i Punës me qëllim verifikimin e zbatimit të planit të Investimeve të OST sh.a. për vitet 2017 dhe 2018.
- Gjatë analizimit të rezultateve të pjesës së parë të monitorimit, nga ana e Bordit të ERE-s u ngriten disa pyetje për të sqaruar më mirë realizimin e investimeve për vitin 2017 dhe 2018 që lidheshin me një analizë mbi zbatimin e realizimin e investimeve, dhe argumentet e grupit të punës lidhur me realizimin faktik të investimeve.
- Gjate monitorimit në zyrat e OST dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e institucionit objekt inspektimi, u analizuan në mënyrë analitike investimet e miratuara nga ERE, diferencat me fondet e prokurimeve, vlerat e kontratave dhe realizimi i tyre brenda afateve të caktuara të kontratës. Gjithashtu janë evidentuar investime të realizuara që nuk kanë qënë të miratuara nga ERE por me Vendim të Këshillit Mbikqyrës të OST, dhe statusi i investimit në momentin e Inspektimit.
- Nga analizimi i investimeve të miratuara për vitin financiar 2017, vërehet se ka shtrirje të realizimit të investimeve përtej afateve të miratuara, realizim të pjesshëm të tyre brenda afateve, rishikim të vlerës së miratuar të investimeve pas vlerës së planit të miratuar nga ERE si dhe ndryshime të investimeve nga situata të paparashikuara por të pa miratuara nga ERE.
- Investimet e parashikuara nga OST për vitin 2018 nuk janë të miratuara nga ERE.

- Për 2018 u evidentuan dhe analizuan në mënyrë të detajuar Investimet e kryera nga OST, vlerat e kontratave, realizimi i tyre brenda afateve të caktuara, statusi I Investimeve në momentin e inspektimit.
- Numri i investimeve të parashikuara nga OST për vitin 2018 është 41.
- Vlera e realizuar e Fondit të miratuar me Vendim të Këshillit Mbikqyrës të OST është 33% e vlerës së Miratuar.
- Nga analizimi i investimeve të miratuara për vitin financiar 2018 rezulton se, investimet e parashikuara dhe pjesërisht të kapitalizuara në Vitin financiar 2018 nuk janë të miratuara nga ERE.
- Informacioni mbi monitorimin lidhur me realizimin e planit të investimeve të OST sha gjatë viteve 2017 dhe 2018 të ushtruar pranë OST sha, i'u bë prezent subjektit me anë të shkresës nr. 823 prot. datë 18.12.2019 e cila i linte afat për të shprehur komente apo sugjerime të mundshme OST sha, por nga ana e shoqërisë nuk është përcjellë asnjë koment apo opinion.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. OST sha duhet të mbajë regjistër të aseteve sipas legjislacionit dhe standarteve në fuqi.
2. Aplikimi për shqyrtim dhe raportet mbi realizimin e planit të investimeve dhe të zhvillimit të rrjetit duhet të bëhen duke zbatuar në mënyrë rigoroze parashikimet e Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe Rregullores së paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga Operatorët, për sa i takon formës dhe përmbajtjes si dhe afateve të paraqitjes.
3. OST sha në vijim duhet të bëjë analiza kosto - përfitim për zërat e planit të investimeve siç kërkohet në Rregulloren e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga Operatorët.
4. OST sha në planet e investimeve sipas viteve tarifore duhet t'i përmbahet në mënyrë rigoroze planit të zhvillimit të rrjetit 10-vjeçar për projektet që parashikohen në këtë plan zhvillimi.
5. OST sha duhet të realizojë planin e investimeve brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe të raportojë në ERE mbi zbatimin.
6. Drejtoria e Monitorimit të Tregut të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet në ERE rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI